



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 22/11/2017

TAKIM PËR BUXHETIMIN ME PJESËMARRJE ME BANORËT E NJËSISË
ADMINISTRATIVE DRENOVË

Bazuar në Ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në vijim të procesit të përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2018, zhvilluam një takim në datë 22/11/2017 me banorët e Njesisë Administrative Drenovë.

Në takim morën pjesë: Zv/Kryetari i Bashkisë Kletjon Kita, staf i bashkisë, banorë të njesisë administrative Drenovë dhe organizata të tjera të interesuara, për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat ku ata jetojnë.

Gjatë takimit, banorët sollën në vëmendje dhe shqyrtuan së bashku disa kërkesa dhe problematika të zonës, të cilat janë të listuara si më poshtë:

- Rikonstruksionin ose ndërtimin e ujësjellësave dhe kanalizimeve në fshatrat e njesisë administrative Drenovë.
- Vazhdimin e procesit për pastrimin e kanaleve kullues dhe vaditës në të gjitha parcelat.
- Rehabilitimin, sistemimin dhe zgjerimin e rrugëve të brendëshme dhe shesheve në fshatra.
- Rehabilitimin dhe ndërtimin e fushave sportive dhe këndeve të lojrave për fëmijët në fshatra.
- Sistemimin e rrugës hyrëse në fshatin Drenovë.
- Rikthimin në gjendjen e mëparshme të rrugës hyrëse në fshatin Qatrom, të amortizuar nga punimet e TAP-it.
- Përmirësimin e ndriçimit në disa zona të fshatrave.

Buxhetimi me pjesëmarrje është një mekanizëm që lejon qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrje dhe ngritjen e transparencës në procesin e hartimit të buxhetit.













